

LIGJ
Nr.9779, datë 16.7.2007

**PËR SIGURINË E PËRGJITHSHME, KËRKESAT THELBËSORE DHE VLERËSIMIN E
KONFORMITETIT TË PRODUKTEVE JOUSHQIMORE**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj përcakton:

1. Të drejtat dhe detyrimet e prodhuesve dhe të shpërndarësve, në mënyrë që produktet për konsumatorët, që vendosen në tregun shqiptar, të jenë të sigurta. Ky ligj nuk zbatohet për produktet e konsumatorëve, të vendosura në treg, që rregullohen me ligje të veçanta.
2. Të drejtat dhe detyrimet e personave, që vendosin produkte në treg. Ky ligj nuk zbatohet për produktet e vendosura në treg, që rregullohen me ligje të veçanta.
3. Procedurat dhe mënyrat e zbatimit të rregullave teknike për produktet dhe vlerësimin e konformitetit.
4. Detyrat, përgjegjësitë, organizimin dhe bashkëpunimin e strukturave përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut.

Neni 2

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Bërje e disponueshme e produktit në treg” është çdo furnizim në tregun shqiptar i produktit në rrjedhën e një aktiviteti tregtar, për shpërndarje, konsum ose përdorim të produktit, me pagesë ose pa pagesë.
2. “Vendosje në treg” është bërja e disponueshme për herë të parë e produktit në tregun shqiptar.
3. “Produkt” është çdo send i ri apo i përdorur, i cili është prodhuar, nxjerrë ose përftuar, pavarësisht nga niveli i përpunimit, i destinuar për t’u vendosur në treg.
4. “Produkt për konsumatorin” është çdo produkt, pavarësisht nëse është i ri, i përdorur apo i riparuar, përfshirë edhe produktin, që përdoret në kuptim të ofrimit të një shërbimi, të destinuar për konsumatorët ose që mund të përdoret prej tyre, edhe nëse nuk është i destinuar për ta, në kushte të arsyeshme, të parashikueshme, i cili bëhet i disponueshëm në treg gjatë një veprimtarie tregtare. Ky përkufizim nuk zbatohet për produktet e përdorura, që vihen në dispozicion, si sende antike, ose për produktet, që duhen riparuar ose ndrequr përpara përdorimit, me kusht që furnizuesi të informojë me hollësi për këtë personin, të cilit i ofrohet produkti.
5. “Konsumator” është çdo person fizik, i cili blen apo përdor produkte për plotësimin e nevojave vetjake, për qëllime që nuk kanë lidhje me veprimtarinë tregtare apo ushtrimin e profesionit. Në kuptim të këtij ligji, konsumatorë janë edhe organizatat jofitimprurëse.
6. “Produkt i sigurt” është çdo produkt për konsumatorin, i cili, në kushte normale ose të arsyeshme, të parashikueshme përdorimi, përfshirë kohëzgjatjen dhe, kur është rasti për vënien në shërbim, edhe kërkesat e instalimit e të mirëmbajtjes, nuk paraqet ndonjë rrezik ose vetëm një shkallë minimale rreziku, të pajtueshëm, me përdorimin e produktit, që vlerësohet i pranueshëm dhe në përputhje me nivelin e lartë të mbrojtjes dhe të sigurisë së personave, duke marrë parasysh, në veçanti,

pikat e mëposhtme:

a) karakteristikat e produktit, përfshirë përbërjen, paketimin, udhëzimet për montimin dhe, kur është e zbatueshme, për instalimin e mirëmbajtjen;

b) efektin te produktet e tjera, kur, në mënyrë të arsyeshme, parashikohet se do të përdoret me produkte të tjera;

c) paraqitjen e produktit, etiketimin, çdo paralajmërim e udhëzim për përdorimin dhe vënien e tij në dispozicion, si dhe çdo shenjë apo informacion tjetër për produktin;

ç) kategoritë e konsumatorëve të rrezikuar nga përdorimi i mallit, veçanërisht fëmijët dhe të moshuarit.

Mundësia e arritjes së niveleve më të larta të sigurisë ose disponueshmëria e produkteve të tjera, që paraqesin një shkallë më të ulët rreziku, nuk do të shërbejë si bazë për të vlerësuar si të rrezikshëm një produkt për konsumatorin.

7. “Produkt i rrezikshëm” është çdo produkt për konsumatorin, i cili nuk është në përputhje me përkufizimin e termit “produkt i sigurt”.

8. “Rrezik serioz” është rreziku, i cili kërkon ndërhyrjen e shpejtë të organeve publike, edhe nëse efektet e tij nuk janë të menjëhershme.

9. “Vlerësim konformiteti” është demonstrimi i përmbushjes së kërkesave të specifikuar për një produkt, proces, sistem, person ose organizëm.

10. “Fabrikues” është personi fizik ose juridik, i cili dizenjon ose fabrikon një produkt, ose që ka një produkt të tillë të dizenuar dhe të fabrikuar nën emrin apo markën e tij.

11. “Prodhues” është:

a) fabrikuesi i produktit, kur është i vendosur në Shqipëri, që monton, paketon, zhvillon ose markon një produkt, për të cilin ai është përgjegjës, sipas këtij ligji dhe çdo person fizik ose juridik, që deklarohet si fabrikues, duke vënë në produkt emrin e vet, markën e tregtimit ose marka të tjera dalluese, ose personi që ndreq produktin;

b) përfaqësuesi në Republikën e Shqipërisë i fabrikuesit, kur fabrikuesi nuk është i vendosur në Shqipëri;

c) importuesi i produktit, kur fabrikuesi nuk është i vendosur në Shqipëri dhe nuk ka përfaqësues në Shqipëri;

ç) persona të tjerë fizikë ose juridikë, të përfshirë në zinxhirin e shpërndarjes, për sa kohë që veprimtaritë e tyre mund të ndikojnë në sigurinë e një produkti.

12. “Importues” është çdo person fizik ose juridik, i vendosur në Shqipëri, i cili ka vendosur në tregun shqiptar një produkt nga një vend tjetër.

13. “Përfaqësues i autorizuar” është çdo person fizik ose juridik i vendosur në Shqipëri, i cili ka një akt përfaqësimi nga fabrikuesi për të vepruar në emër të tij për detyra specifike, lidhur me detyrimet e fabrikuesit që parashikohen nga dispozitat e këtij ligji.

14. “Personi që vendos në treg një produkt” është:

a) fabrikuesi, kur ai është i vendosur në Shqipëri;

b) përfaqësuesi i autorizuar, kur fabrikuesi nuk është i vendosur në Shqipëri;

c) importuesi, kur fabrikuesi nuk është i vendosur në Shqipëri dhe nuk ka përfaqësues të autorizuar të tij.

15. “Shpërndarës” është çdo person fizik ose juridik, i përfshirë në zinxhirin e shpërndarjes, që bën të disponueshëm produktin në treg, veprimtaria e të cilit nuk ndikon në sigurinë e produktit.

16. “Kërkesa thelbësore” janë kërkesa të detyrueshme, për aspektet e shëndetit dhe të sigurisë së produkteve, që mbulohen me rregullat teknike, të përcaktuara në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji. Kërkesat thelbësore përcaktojnë rezultatet që duhen arritur, por nuk specifikojnë zgjidhje teknike për t’i realizuar ato.

17. “Rregull teknik” është një ligj dhe/ose një akt nënligjor, që përcakton kërkesat e sigurisë së produkteve apo përcakton detyrime për vendosjen në treg të një produkti, përdorimin e tij, ndalimin e prodhimit, të importit dhe/ose tregtimit.

18. “Standard shqiptar” është një dokument vullnetar, i krijuar me konsensus dhe i miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Standardeve, në përputhje me kërkesat e ligjit për standardizimin, që siguron, për përdorim të njëjtë dhe të vazhdueshëm, rregulla, udhëzime ose karakteristika për veprimtaritë ose rezultatet e tyre, për arritjen e një shkalle optimale të rregullsisë në një kontekst të dhënë. Standardet shqiptare shënohen me “SSH”.

19. “Standard i harmonizuar shqiptar” është një standard shqiptar, që transponon një standard të harmonizuar europian, në mbështetje të këtij ligji dhe të rregullave teknike, të renditura në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji, sipas listës së përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit, ministrisë së linjës dhe bashkërendimit me ministritë përgjegjëse dhe/ose me autoritetet e tjera të administratës qendrore. Lista e standardeve të harmonizuara shqiptare ose çdo ndryshim i saj botohen në Fletoren Zyrtare.

20. “Organ i autorizuar” është një person juridik i vendosur në Republikën e Shqipërisë, i autorizuar për të kryer detyra të veçanta të vlerësimit të konformitetit, sipas rregullave teknike të përcaktuara në pikën 1 të nenit 8 të këtij ligji.

21. “Autorizim” është dhënia e së drejtës, nga ministri përgjegjës, një organi të vlerësimit të konformitetit, për të kryer veprimtaritë specifike të vlerësimit të konformitetit.

22. “Tërheqje e produkteve” është çdo masë e marrë, me qëllim kthimin mbrapsht të produkteve që ndërkohë janë bërë të disponueshme te përdoruesi i fundit.

23. “Pezullim” është çdo masë e marrë për të parandaluar bërjen të disponueshëm në treg të një produkti në zinxhirin e furnizimit.

24. “Akreditim” është dëshmia nga një palë e tretë, që shpreh, zyrtarisht, përgjegjësinë e një organi vlerësimi të konformitetit, për të kryer detyrat specifike të vlerësimit të konformitetit.

25. “Ministria” është ministria që mbulon çështjet e tregtisë dhe të industrisë.

KREU II

KËRKESAT E SIGURISË SË PËRGJITHSHME TË PRODUKTEVE PËR KONSUMATORËT

Neni 3

Vendosja në treg

Prodhuesit janë të detyruar të vendosin në treg vetëm produkte të sigurta.

Neni 4

Detyrimi i përgjithshëm

Kur produktet për konsumatorët janë objekt i kërkesave specifike të sigurisë, sipas legjislacionit në fuqi, ky kre do të zbatohet vetëm ndaj aspekteve dhe rreziqeve apo kategorive të rrezikut, të cilat nuk mbulohen nga këto kërkesa.

Neni 5

Prezumimi i sigurisë

1. Një produkt për konsumatorin vlerësohet i sigurt nëse është në përputhje me një standard të harmonizuar shqiptar, të botuar në Fletoren Zyrtare.

2. Kur një produkt për konsumatorin, megjithëse është në përputhje me një standard të harmonizuar shqiptar apo pjesë të një standardi të tillë, nuk mund të prezumohet më tej i sigurt, standardi shfuqizohet tërësisht ose pjesërisht nga lista e standardeve të harmonizuara shqiptare, sipas pikës 1 të këtij neni.

3. Në rrethana të tjera nga ato të përmendura në pikën 1 të këtij neni, përputhshmëria e një produkti për konsumatorët me kërkesat e përgjithshme të sigurisë vlerësohet, duke pasur parasysh elementet e mëposhtme:

a) standardet shqiptare, që zbatojnë standardet përkatëse europiane, në dallim nga ato të parashikuara në pikën 1 të këtij neni;

b) standardet e tjera shqiptare apo standardet kombëtare, të hartuara nga vendet anëtare të Bashkimit Europian, ku produktet për konsumatorët janë vendosur në treg;

c) rekomandimet e Komisionit Europian për vlerësimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët;

ç) kodet në fuqi të praktikave rezultative për sigurinë e produkteve për konsumatorët në sektorët e interesuar;

d) nivelin e teknologjisë dhe të artizanatit;

dh) pritshmërinë e arsyeshme të konsumatorëve për sigurinë e produktit.

4. Përputhshmëria e një produkti për konsumatorët me kërkesat e përgjithshme të sigurisë nuk pengon strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për marrjen e masave të duhura, për të vënë kufizime për vendosjen në treg ose për të kërkuar pezullimin apo tërheqjen e produktit nga tregu, kur provohet se, pavarësisht përputhshmërisë, paraqet rrezik.

Neni 6

Detyrime të tjera për sigurinë e produkteve për konsumatorët

1. Brenda kufijve të veprimtarisë, prodhuesit duhet t'u sigurojnë konsumatorëve të gjitha të dhënat përkatëse, për t'u mundësuar vlerësimin e rrezikut të qenësishëm në një produkt për konsumatorët, gjatë periudhës normale apo të arsyeshme të parashikueshme të përdorimit të tij, kur rreziqet nuk janë menjëherë evidente, pa paralajmërimin e përshtatshëm dhe marrjen e masave paraprake ndaj këtyre rreziqeve. Prania e paralajmërimit nuk çliron asnjë person nga përputhshmëria e detyruar me kërkesat e tjera, të vendosura në këtë ligj.

2. Prodhuesit, brenda kufijve të veprimtarisë, duhet të ndërmarrin masa të mjaftueshme, që u përgjigjen karakteristikave të produkteve për konsumatorët që ata furnizojnë, duke mundësuar kështu që prodhuesit:

a) të jenë në dijeni për rreziqet, që mund të mbartin këto produkte;

b) të ndërmarrin veprimet e duhura, për të shmangur këto rreziqe, si pezullimin nga tregu, paralajmërimin në mënyrë të përshtatshme dhe efektive të konsumatorëve apo tërheqjen e produkteve nga konsumatorët.

3. Masat e mësipërme mund të përfshijnë:

a) të dhënat, nëpërmjet produktit për konsumatorët apo paketimit të tij, për identitetin dhe hollësi të tjera për prodhuesin dhe produktin përkatës për konsumatorët ose, kur është e zbatueshme, të dhëna për grupin e produkteve për konsumatorët, të cilit i përket;

b) kryerjen e testeve të mostrave të produkteve për konsumatorët, të tregtuara, hetimin, mbajtjen e një regjistri ankesash, si dhe vënien në dijeni të shpërndarësve për një kontroll të tillë.

Masat e parashikuara në shkronjën "b" të kësaj pike mund të ndërmerren, në baza vullnetare apo me kërkesë të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, sipas kreut IV të këtij ligji.

4. Shpërndarësit duhet të veprojnë për të ndihmuar sigurimin e përputhshmërisë me kërkesat e zbatueshme të sigurisë, veçanërisht duke mos furnizuar produkte për konsumatorët, për të cilat ata kanë dijeni apo mund të gjykojnë në bazë të nivelit profesional ose të të dhënave që zotërojnë, se nuk janë në përputhje me këto kërkesa. Shpërndarësit, brenda kufijve të veprimtarisë, duhet të marrin pjesë në monitorimin e sigurisë së produkteve për konsumatorët, të vendosura në treg, veçanërisht duke përcjellë të dhëna për rrezikun e tyre, duke mbajtur dhe duke dhënë dokumentacionet e nevojshme për gjurmueshmërinë e origjinës së produkteve dhe për veprimet e ndërmarra nga prodhuesit e strukturat përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut, për të shmangur rreziqet ndaj konsumatorëve.

5. Kur prodhuesit dhe shpërndarësit dinë apo duhet të dinë, në bazë të nivelit profesional dhe të dhënave që zotërojnë, se një produkt për konsumatorin, që ata e kanë vendosur në treg, nuk është në përputhje me kërkesat e sigurisë së përgjithshme dhe paraqet rrezik për konsumatorët, ata vënë në dijeni menjëherë, me shkrim, strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, duke dhënë hollësi dhe veçanërisht të dhëna për veprimet e ndërmarra, për parandalimin e rrezikut ndaj konsumatorëve. Të dhënat përfshijnë:

a) identifikimin e saktë të produktit për konsumatorët apo të grupit të produkteve, të cilit i përket;

b) një përshkrim të plotë të rrezikut, që paraqet produkti për konsumatorin;

c) të gjitha të dhënat përkatëse për gjurmimin e produktit për konsumatorët;

ç) përshkrimin e veprimeve të ndërmarra për parandalimin e rrezikut ndaj konsumatorëve.

6. Prodhuesit dhe shpërndarësit, brenda kufijve të veprimtarisë, bashkëpunojnë me strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, me kërkesë të këtyre të fundit, për veprimet e ndërmarra për shmangien e rreziqeve, që mbartin produktet për konsumatorët, që ata shpërndajnë apo kanë shpërndarë.

RREGULLAT TEKNIKE DHE VLERËSIMI I KONFORMITETIT TË PRODUKTEVE

Neni 7

Ky kre zbatohet vetëm për produktet, që mbulohen nga rregullat teknike, titujt e të cilave janë renditur në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 8

Rregullat teknike

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë akte nënligjore për rregullat teknike të produkteve, të renditura në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji.

2. Rregullat teknike, sipas pikës 1 të këtij neni, përcaktojnë kërkesat thelbësore dhe procedurat e vlerësimit të konformitetit, në përputhje me dispozitat e këtij kreu.

Neni 9

Vendosja në treg

1. Vendosja në treg e produktit që mbulohet nga rregullat teknike është nën përgjegjësinë e plotë të personit që e vendos në treg këtë produkt. Produkti vendoset në treg vetëm nëse përmbushen kërkesat e mëposhtme:

- a) përputhen me rregullat teknike të zbatueshme;
- b) përputhshmëria me rregullat teknike është vlerësuar sipas procedurave të përcaktuara për vlerësimin e konformitetit;
- c) kanë markën e konformitetit, në përputhje me rregullat teknike përkatëse.

2. Përputhshmëria e produkteve me kërkesat thelbësore të rregullave teknike dokumentohet nga deklaratat e konformitetit të fabrikuesit ose të përfaqësuesit të tij të autorizuar, nga raportet e testimit, certifikatat ose raportet e inspektimit, në përputhje me procedurat e vlerësimit të konformitetit, si edhe nga marka e konformitetit, e përcaktuar në rregullat teknike të zbatueshme.

3. Nëse një produkt është objekt i disa rregullave, marka e konformitetit tregon se ai plotëson kërkesat e përcaktuara të të gjitha rregullave teknike të zbatueshme përkatëse.

4. Shpërndarësi vepron për të parandaluar shpërndarjen e produkteve, që mbulohen nga rregullat teknike, të cilat nuk plotësojnë dukshëm kërkesat e këtij ligji dhe/ose rregullat teknike përkatëse.

Neni 10

Prezumimi i konformitetit

1. Produkti prezumohet se është në përputhje me kërkesat thelbësore të rregullave teknike të zbatueshme kur është në përputhje me standardet e harmonizuara shqiptare, të botuara në Fletoren Zyrtare.

2. Kur një produkt, megjithëse është në përputhje me një standard të harmonizuar shqiptar ose pjesë e një standardi të tillë, nuk prezumohet më tej, në përputhje me kërkesat thelbësore të rregullave teknike. Kur ky produkt mund të rrezikojë sigurinë e jetës, të shëndetit, mjedisit dhe interesat e tjerë publikë, standardi shfuqizohet pjesërisht ose plotësisht.

3. Kur provohet se, pavarësisht përputhshmërisë së një produkti me kërkesat thelbësore të rregullave teknike, ai mund të rrezikojë sigurinë e jetës, shëndetit, mjedisit dhe interesave të tjerë publikë, struktura përgjegjëse për mbikëqyrjen e tregut merr masa për të vendosur kufizime për bërjen të disponueshme të produktit në treg ose kërkon pezullimin apo tërheqjen e produktit nga tregu.

Neni 11

Marka dhe deklaratat e konformitetit

1. Marka e konformitetit vendoset nga fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar. Produkti, i cili rezulton në përputhje me kërkesat thelbësore të rregullave teknike, përputhshmëria e të cilit është vlerësuar, sipas procedurave të vlerësimit të konformitetit, të parashikuara në nenin 12 të këtij ligji, i

vihet marka e konformitetit, në qoftë se kjo kërkohet nga rregullat teknike përkatëse. Një dokument i posaçëm hartohet dhe shoqëron produktin, nëse kjo përcaktohet në rregullat teknike të zbatueshme, ku deklarohet, me shkrim, nga fabrikuesi përputhja e produktit me rregullat teknike. Forma dhe përmbajtja e kësaj deklarate të konformitetit jepen në rregullat teknike përkatëse.

2. Forma, kuptimi dhe simboli i markës/markave të konformitetit përcaktohen në rregullat teknike përkatëse.

3. Nuk lejohet vendosja e markës së konformitetit ose e markave të tjera, të ngjashme me markën e konformitetit, të cilat shkaktojnë keqkuptime në treg dhe çorientojnë konsumatorin. Nuk lejohet vendosja e markës së konformitetit për produktet që nuk përputhen me rregullat teknike përkatëse ose për produktet, për të cilat vendosja e markës së konformitetit nuk kërkohet.

Neni 12

Vlerësimi i konformitetit

1. Përpara vendosjes në treg të produktit që mbulohet nga rregullat teknike, personi që e vendos në treg këtë produkt siguron përputhshmërinë e tij me kërkesat thelbësore të të gjithë rregullave të zbatueshme teknike.

2. Rregullat teknike, nëpërmjet specifikimit ose ndërthurjes së procedurave të vlerësimit të konformitetit, përcaktojnë për grupe produktesh, sipas kompleksitetit të tyre teknik dhe shkallës së mundshme të rrezikshmërisë për përdorimin e tyre, kushtet për vendosjen në treg ose për përdorimin e përsëritur, përfshirë veprimtaritë dhe procedurat e ndjekura gjatë vlerësimit të konformitetit.

3. Procedurat e vlerësimit të konformitetit, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, janë:

a) vlerësimi i konformitetit në kushte të veçanta, i kryer nga fabrikuesi;
b) vlerësimi i konformitetit të një mostre të produktit, i kryer nga organi i autorizuar;
c) vlerësimi i konformitetit, përmes të cilit organi i autorizuar ekzaminon karakteristikat e produktit dhe verifikon, me zgjedhje të rastësishme, përputhjen e produkteve me kërkesat e përcaktuara;

ç) vlerësimi nga organi i autorizuar i sistemit të cilësisë së prodhimit ose i komponentëve të tij në ndërmarrje dhe mbikëqyrja për funksionimin e duhur të sistemit;

d) verifikimi i përputhshmërisë së produkteve me një tip produkti të certifikuar, ose me kërkesat e veçanta, të kryera nga prodhuesi, përfaqësuesi i tij i autorizuar, personi që vendos produktin në treg, ose nga një organ i autorizuar, për çdo produkt apo mostër të përzgjedhur statistikisht;

dh) verifikimi nga një organ i autorizuar i përputhshmërisë së çdo produkti me kërkesat e përcaktuara;

e) mbikëqyrja nga një organ i autorizuar i funksionimit të duhur të sistemit të cilësisë në ndërmarrje dhe, nëse është e nevojshme, vlerësimi në fazën e projektimit, të konformitetit të produktit me kërkesat e rregullave teknike;

ë) vlerësimi i veprimtarive për prodhimin e produkteve;

f) procedura të tjera të vlerësimit të konformitetit, nëse është e nevojshme, duke përfshirë veprimtaritë e një organi të akredituar ose të një personi tjetër.

4. Koston për veprimet e organit të autorizuar në vlerësimin e konformitetit e mbulon subjekti, i cili i kërkon këto veprime.

5. Fabrikuesi mban dosjen teknike për të siguruar konformitetin e produktit dhe deklaratën e konformitetit për një periudhë 10-vjeçare pas prodhimit të produktit të fundit. Personi që vendos produktin në treg i paraqet dosjen teknike strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, me kërkesën e kësaj të fundit. Përmbajtja e dosjes teknike përcaktohet në rregullat teknike.

6. Fabrikuesi/importuesi shënon në produkt emrin dhe adresën e tij të kontaktit. Kur përmasat ose natyra e produktit nuk e mundëson dot këtë, të dhënat e mësipërme shënohen në paketimin e produktit ose në një dokument që shoqëron produktin.

7. Importuesi duhet të mbajë kopjen e deklaratës së konformitetit në dispozicion të strukturave përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut për një periudhë 10-vjeçare.

Neni 13

Organet e autorizuara

Organet e autorizuara, të njohura dhe të autorizuar në procesin dhe procedurat e përcaktuara

në nenin 14 të këtij ligji, kryejnë veprimtari, sipas objektit të përcaktuar në vendimin e autorizimit dhe, në mënyrë të veçantë, duhet:

a) të kryejnë me objektivitet dhe profesionalizëm ekzaminimin teknik, në përputhje me nivelin e shkencës, të artit dhe teknologjisë, në kohën kur kryhet ky ekzaminim;

b) të lëshojnë, bazuar në ekzaminimin teknik, certifikata ose raporte të vlerësimit të konformitetit dhe të testeve, sipas procedurave të vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në rregullat teknike;

c) të tërheqin certifikata ose dokumente të tjera, sipas shkronjës “a” të këtij neni, në rastet kur vihen në dijeni se produkti nuk është më në përputhje me kërkesat e përcaktuara në rregullat teknike;

ç) të sigurojnë kopje të certifikatave, raporte të vlerësimit të konformitetit dhe të testimit, përfshirë të dhëna dhe dokumente për lëshimin, refuzimin ose heqjen e certifikatës ministrit përgjegjës, strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut dhe strukturave të tjera përkatëse, me kërkesën e tyre;

d) të vënë në dijeni, pa vonesë, ministrinë përgjegjëse, për çdo rast kur janë të paaftë të sigurojnë përmbushjen e kushteve të përcaktuara në autorizim.

Neni 14

Autorizimi

1. Për çdo rregull teknik, të listuar në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji, ministri përgjegjës mund të autorizojë një ose disa organe, për të kryer detyrat e përcaktuara në nenin 13 të këtij ligji, për procedurat specifike të vlerësimit të konformitetit. Vetëm një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar, mund të autorizohet. Për çdo organ të autorizuar, ministri përgjegjës miraton një vendim, ku, domosdoshmërisht, përcaktohen:

a) emri, adresa dhe të gjitha të dhënat e identifikimit të organit të autorizuar;

b) rregulli teknik, për të cilin organi është autorizuar;

c) detyra/detyrat specifike të vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara nga rregulli teknik përkatës për çdo organ të autorizuar.

2. Rregullat teknike, titujt e të cilave janë të renditura në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji, përcaktojnë kriteret që duhet të përmbushin organet e autorizuar. Këto kriteret kanë të bëjnë me një ose disa nga aspektet e mëposhtme:

a) pavarësinë për:

i) lidhjet jo të drejtpërdrejta me projektuesin, prodhuesin, furnizuesin, instaluesin, blerësin, pronarin ose mbajtësin e produkteve të vlerësuara apo me përfaqësuesin e autorizuar të tyre;

ii) mosdhënien e këshillimit për veprimtaritë e vlerësimit të konformitetit dhe kategoritë e produkteve, që kanë autorizuar;

iii) organet e autorizuar të inspektimit në qendrat e punës;

b) paanshmërinë dhe integritetin që nënkupton:

i) një shkallë të lartë të integritetit profesional;

ii) mosndikimin nga çdo presion dhe ndërhyrje;

iii) mospërdorimin e metodave diskriminuese;

c) kompetencën profesionale për procedurën/procedurat e vlerësimit të konformitetit dhe kategorinë e produktit, duke pasur parasysh disponibilitetin:

i) e personelit të mjaftueshëm, me njohuri dhe përvojë teknike të përshtatshme;

ii) e të gjitha mjeteve të domosdoshme, për kryerjen e detyrave të vlerësimit të konformitetit, për të cilat organi është autorizuar;

iii) e përdorimit të të gjitha mjediseve dhe pajisjeve të domosdoshme;

ç) nënkontraktimin, duke pasur parasysh kërkesat që duhen plotësuar si nga nënkontraktori, edhe nga pala nënkontraktore;

d) sigurimin e përgjegjësisë, duke iu referuar:

i) kërkesave për organin e autorizuar, për të siguruar kontratën e përgjegjësisë;

ii) kushteve, kur organi i autorizuar është i përjashtuar nga ato;

dh) besueshmërinë për:

i) ruajtjen e fshehtësisë profesionale;

ii) ruajtjen e të drejtave të pronësisë;
e) pjesëmarrjen në veprimtaritë bashkërenduese dhe të standardizimit, duke pasur parasysh:
i) domosdoshmërinë, që duhet të mbajë organi i autorizuar për të qenë i informuar dhe i përditësuar me zhvillimet më të fundit në fushën e tij të autorizimit;

ii) mjetet e duhura, për të arritur këtë pjesëmarrje.

Rregullat teknike, titujt e të cilave janë të renditura në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji, mund të përfshijnë edhe kritere të tjera.

3. Ministri përgjegjës siguron se organi i autorizuar vepron në përputhje me dispozitat e këtij ligji, rregullat teknike dhe kushtet e përcaktuara në vendimin e autorizimit dhe ka të drejtën që, në çdo kohë, të urdhërojë inspektime në organin e autorizuar. Ministri përgjegjës ngarkon Drejtorinë e Përgjithshme të Akreditimit që, gjatë veprimtarisë mbikëqyrëse, të vlerësojë tek organi i autorizuar edhe vazhdueshmërinë e plotësimit të kriterëve të dhëna në këtë ligj apo në rregullat teknike përkatëse.

4. Ministri përgjegjës shfuqizon autorizimin nëse organi i autorizuar dështon në plotësimin e njërit ose të disa kriterëve apo kërkesave të përcaktuara të rregullave teknike përkatëse dhe kushteve të përcaktuara në vendimin e autorizimit, ose kur një gjë e tillë kërkohet nga organi i autorizuar.

5. Shfuqizimi i autorizimit nuk ndikon në vlefshmërinë e certifikatave, të raporteve të testimit dhe inspektimit, të lëshuara nga organi i autorizuar, përpara vendimit të shfuqizimit. Certifikatat dhe raportet e testimit e të inspektimit e humbin vlefshmërinë e tyre dhe shfuqizohen nëse kjo masë është tejet e domosdoshme dhe sepse kështu ka vendosur ministri përgjegjës.

6. Çdo autorizim, përfshirë edhe fushën e tij, si dhe çdo shfuqizim botohen në Fletoren Zyrtare.

7. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë një vendim për procedurat e autorizimit.

Neni 15

Vlefshmëria e dokumenteve dhe e markave të konformitetit, të lëshuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë

1. Certifikatat, raportet e testimit dhe të inspektimit, të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit të vendeve anëtare të Bashkimit Europian, njihen nga Republika e Shqipërisë. Produktet e importuara, që janë objekt i rregullave teknike, të përcaktuara në aneksin, që i bashkëlidhet këtij ligji dhe mbajnë ligjërisht markën europiane përkatëse të konformitetit prezumohen që janë në përputhje me dispozitat e këtij ligji.

2. Certifikatat, raportet e testimit dhe të inspektimit, të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit në vendet jashtë Bashkimit Europian, njihen dhe pranohen në Republikën e Shqipërisë, nëse këto organe janë të akredituara nga një organ akreditues, nënshkrues i marrëveshjeve për njohjen e ndërsjellë me Organizatën Europiane për Akreditim, Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve ose Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit, duke siguruar se detyrat e vlerësimit të konformitetit përfshihen në fushën e marrëveshjeve të njohjes, ku organi akreditues është edhe nënshkrues.

3. Certifikatat, raportet e testimit dhe të inspektimit, të lëshuara nga organet e vlerësimit të konformitetit, akreditimi i të cilave nuk është kryer nga organet akredituese, nënshkruese të marrëveshjeve shumëpalëshe me Organizatën Europiane për Akreditim, Organizatën Ndërkombëtare për Akreditimin e Laboratorëve ose Forumin Ndërkombëtar të Akreditimit, njihen nga Republika e Shqipërisë, bazuar në procedurat ekuivalente të akreditimit. Ekuivalenca vlerësohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë.

KREU IV

MBIKËQYRJA E TREGUT

Neni 16

Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut

1. Detyrimi për kontrollin e zbatimit të dispozitave të këtij ligji për sigurinë e produkteve kryhet nga:

a) struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, e parashikuar në këtë ligj;

b) strukturë tjetër, e krijuar me ligj të veçantë.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të përcaktojë mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, në përputhje me këtë ligj.

3. Deri në krijimin e strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, përgjegjësitë dhe funksionet kryhen nga Inspektorati Qendror Teknik, i krijuar me ligjin nr.9595, datë 27.7.2006 “Për ngritjen e Inspektoratit Qendror Teknik”.

Neni 17

Detyrime dhe kompetenca të veçanta

1. Struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut është e autorizuar të ndërmarrë, ndërmjet të tjerave, kur është e përshtatshme, masat e mëposhtme:

a) për çdo produkt të konsumatorëve, pasi është vendosur në treg si i sigurt:

i) të organizojë verifikime për karakteristikat e sigurisë, në një shkallë të përshtatshme, deri në fazën përfundimtare të përdorimit ose të konsumit;

ii) të kërkojë të gjitha të dhënat e nevojshme nga palët e interesuara;

të marrë mostra të produkteve dhe t’ua nënshtrojë kontrolleve të sigurisë;

iii) për çdo produkt për konsumatorin, që në disa rrethana mund të paraqesë rreziqe:

b) të kërkojë të shënohen paralajmërime, në mënyrë të dukshme, lehtësisht të kuptueshme, në gjuhën shqipe, me fjalë të qarta e të përshtatshme, për rreziqet që produkti mund të paraqesë;

i) të bëjë tregtimin e tij objektiv të kushteve paraprake, për të qenë i sigurt;

ii) për çdo produkt të konsumatorëve, që mund të paraqesë rreziqe për disa konsumatorë:

c) të urdhërojë, që konsumatorët të paralajmërohen në kohë dhe në formë të përshtatshme për rrezikun, përfshirë dhe botimin e paralajmërimeve të veçanta;

ç) për çdo produkt të dyshuar, që nuk plotëson kërkesat thelbësore të përcaktuara në rregullat teknike:

i) të ndalojë, për një periudhë kohe të domosdoshme për kontrolle, verifikime dhe vlerësime të ndryshme të sigurisë, furnizimin, shpërndarjen ose ekspozimin e produktit;

d) për çdo produkt, që rezulton i pasigurt:

i) të ndalojë tregtimin e tij dhe të vendosë masat shoqëruese të nevojshme, për të siguruar efikasitetin e ndalimit;

dh) për çdo produkt të gjetur të pasigurt dhe të vendosur në treg:

i) të urdhërojë ose të organizojë pezullimin e menjëhershëm të tij dhe të lajmërojë konsumatorët dhe/ose përdoruesit e fundit për rreziqet që paraqet;

ii) të urdhërojë, të bashkërendojë ose, nëse është e përshtatshme, të organizojë, së bashku me prodhuesit dhe shpërndarësit, tërheqjen e produktit nga konsumatorët dhe/ose përdoruesit e fundit, si dhe shkatërrimin e tij në kushte të përshtatshme.

2. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr masat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, në veçanti ato të parashikuara në shkronjat “ç” deri në “dh”, vepron në përputhje me detyrimet ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe, në këtë mënyrë, zbaton masat në raport me seriozitetin e rrezikut, si dhe duke pasur parasysh parimin parandalues.

3. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut gjen mangësi, të cilat mund të shmangen, urdhëron mënjanimin e tyre brenda një afati të përcaktuar kohor.

4. Nëse është e nevojshme, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut mund t’u referohet masave të parashikuara në shkronjën “dh” të pikës 1 të këtij neni, nëse veprimi i ndërmarrë nga prodhuesit dhe shpërndarësit, për përmbushjen e detyrimeve të tyre, sipas pikës 2 të nenit 6 të këtij ligji, është i pakënaqshëm ose i pamjaftueshëm. Tërheqja e produktit zbatohet si hapi i fundit.

5. Në veçanti, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut ndërmerr veprimet e nevojshme, kur produktet paraqesin rrezik serioz dhe merr masat e përshtatshme në kohën e duhur, të parashtruara në shkronjat “b” deri në “dh” të pikës 1 të këtij neni. Këto masa përcaktohen duke u vlerësuar, rast pas rasti, nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut. Masat e marra nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut, sipas këtij neni, kanë të bëjnë, sipas rastit, me:

a) prodhuesit;

b) shpërndarësit, brenda kufijve të veprimtarisë përkatëse dhe, në veçanti, palën përgjegjëse për fazën e parë të shpërndarjes në tregun shqiptar;

c) çdo person tjetër, kur është e nevojshme, për bashkëpunimin në veprimin e marrë, për

shmangien e rreziqeve që rrjedhin nga produkti.

Neni 18

Masat për të siguruar mbikëqyrjen efektive të tregut

1. Ministria, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse dhe strukturat përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, vepron në mënyrë që të sigurojë mbikëqyrje efektive të tregut, duke synuar garantimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së shëndetit dhe sigurisë së konsumatorëve, nëpërmjet përdorimit të mjeteve dhe zbatimit të procedurave të përshtatshme, të cilat, në veçanti, përfshijnë:

a) zhvillimin e vazhdueshëm të bashkëpunimit të ngushtë dhe efektiv ndërmjet strukturave përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut;

b) hartimin, përditësimin periodik dhe zbatimin e programeve sektoriale të mbikëqyrjes, sipas kategorive të produkteve ose rreziqeve dhe monitorimin e veprimtarive të mbikëqyrjes, përfundimeve dhe rezultateve;

c) ndjekjen dhe përditësimin e njohurive shkencore dhe teknike për sigurinë e produkteve;

ç) rishikimin periodik dhe vlerësimin e funksionimit të veprimtarive të kontrollit dhe efektivitetin e tyre, si dhe, nëse është e nevojshme, rishikimin e përqasjeve të mbikëqyrjes.

2. Ministria, ministritë përgjegjëse dhe struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut sigurojnë që konsumatorëve dhe palëve të tjera të interesuara t'u jepet mundësia për të paraqitur ankesa te strukturat përgjegjëse për sigurinë e produkteve, mbikëqyrjen dhe veprimtaritë e kontrollit. Ministria, ministritë përgjegjëse dhe struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut vënë në dijeni, vazhdimisht, konsumatorët dhe palët e tjera të interesuara për procedurat e vendosura deri në fund.

3. Për çdo masë të marrë sipas këtij ligji, që përfshin kufizimet për bërjen e disponueshme të produktit në treg, pezullimin apo tërheqjen e tij, deklarohen arsyet përkatëse, për të cilat është marrë. Këto i lajmërohen palës së interesuar, duke i shpjeguar edhe mundësinë e ndreqjes dhe afatin kohor në dispozicion.

4. Palëve të interesuara u jepet mundësia për të dhënë mendim përpara marrjes së masës. Në raste të veçanta, kjo mundësi u jepet ndërkohë që masa është zbatuar.

Neni 19

Rregullime të veçanta

1. Kur struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut gjen se një produkti i është vënë në mënyrë të paligjshme një markë konformiteti, sipas këtij ligji, ai mund të ndalojë bërjen e disponueshme të një produkti të tillë në treg dhe shpërndarjen e tij të mëtejshme, si dhe i jep një afat kohor për të ndrequr situatën e paligjshme.

2. Në rastin kur personi që ka vendosur produktin në treg nuk është dakord me masën e vendosur, sipas pikës 1 të këtij neni, ai mund ta kundërshtojë brenda 30 ditëve pune, nga data kur është njohur me raportin me shkrim për masën. Ankimimi nuk ka efekt pezullues. Për kundërshtimet e paraqitura drejtuesi/kryetari i strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut merr vendim brenda 30 ditëve pune, i cili i komunikohet menjëherë personit që ka vendosur produktin në treg.

3. Kur masat e vendosura, sipas pikës 1 të këtij neni, nuk janë ndrequr brenda afatit kohor të përcaktuar për ndreqjen e situatës, struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut merr vendim për një masë mbrojtëse, që ka të bëjë me detyrimin e personit përgjegjës për vendosjen e produktit në treg, për pezullimin ose tërheqjen e produktit nga tregu.

Neni 20

Shkëmbimi i informacionit

1. Ministria është përgjegjëse, në nivel kombëtar, për zhvillimin e rrjetit të informacionit për produktet dhe produktet e konsumatorëve për shkëmbimin e të dhënave përkatëse në nivel dy dhe shumëpalësh, kur janë arritur marrëveshje të tilla. Bëjnë përjashtim produktet e parashikuara në ligje të veçanta dhe veçanërisht në sektorët:

a) e ushqimit, ku ministria përgjegjëse është ministria që mbulon çështjet e bujqësisë dhe të ushqimit;

b) farmaceutikë, ku ministria përgjegjëse është ministria që mbulon çështjet e shëndetësisë.

2. Ministria, në bashkëpunim me ministritë përgjegjëse dhe strukturën përgjegjëse të

mbikëqyrjes së tregut, shkëmben dhe mbledh të dhëna për produktet e pasigurta dhe ato potencialisht të pasigurta.

3. Të dhënat që mbledh struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut dhe ministria, për rreziqet që paraqet një produkt për shëndetin dhe sigurinë e konsumatorit, u transmetohen, në mënyrë transparente, konsumatorëve, duke respektuar parimin e ruajtjes së sekretit profesional. Konsumatorët, në mënyrë të veçantë, duhet të kenë akses mbi këto të dhëna për identifikimin e produkteve, natyrën e rrezikut dhe masat e marra.

KREU V KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 21

Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:

1. Për shkelje të dispozitës së parashikuar në nenin 3 dhe nenin 19 pika 3 me gjobë jo më pak se 200 000 lekë deri në 8 për qind të xhiros vjetore të subjektit që ka kryer shkeljen.

2. Për shkelje të dispozitës së parashikuar në nenin 6 pika 1 dhe nenin 9 pika 1 shkronjat “a” dhe “b” me gjobë 6 000 000 lekë.

3. Për shkelje të dispozitës së parashikuar në nenin 6 pikat 2, 4 dhe 5 me gjobë 300 000 lekë.

4. Për shkelje të dispozitës së parashikuar në nenin 6 pika 6, nenin 9 pika 2, nenin 11 pika 3, nenin 12 pikat 5, 6 dhe 7 dhe nenin 19 pika 1 me gjobë 5 000 000 lekë.

5. Për shkelje të dispozitës së parashikuar në nenin 9 pika 1 shkronja “c” dhe nenin 12 pika 8 me gjobë 400 000 lekë.

6. Kur subjekti nuk ka pajisur brenda afatit kohor të dhënë strukturën përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut me dokumentacionin/informacionin e kërkuar, apo me veprimet/mosveprimet e tij e bën të pamundur ose e vështirëson verifikimin e dokumentacionit/informacionit, me gjobë 200 000 lekë.

Neni 22

Në përputhje me nenin 16 të këtij ligji, shkeljet me karakter administrativ verifikohen dhe dënohen nga struktura përgjegjëse e mbikëqyrjes së tregut.

Neni 23

1. Gjoha vendoset brenda 2 muajve nga data kur inspektori i strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut konstaton shkeljen e kryer nga personi që ka vendosur në treg produktin, por jo më vonë se 1 vit nga data kur është konstatuar shkelja.

2. Personi që ka vendosur në treg produktin duhet të shlyejë gjobën brenda 10 ditëve nga data që ka marrë njoftim për vendosjen e saj.

3. Gjoha e vendosur nga inspektorët e strukturave përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, në zbatim të këtij ligji, është titull ekzekutiv dhe ekzekutohet nga zyrat e përmbarimit në rast se nuk shlyhet në kohë nga personi që ka vendosur produktin në treg.

Neni 24

Procedurat e ankimit

1. Personi që ka vendosur produktin në treg, ndaj të cilit vendoset masa administrative, ka të drejtë të kërkojë rishqyrtimin e saj pranë kryetarit të strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për masën administrative. Kryetari i strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut merr vendim për rishqyrtim brenda 30 ditëve nga data e depozitimit të kërkesës.

2. Kundër vendimit të dhënë nga kryetari i strukturës përgjegjëse të mbikëqyrjes së tregut, personi që ka vendosur produktin në treg mund të bëjë ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

Neni 25

Të ardhurat, që burojnë nga vjelja e gjobave, derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU VI
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 26

Kur dispozitat e akteve ligjore ose nënligjore për procedurat dhe mënyrat e zbatimit të rregullave teknike për produktet dhe administrimin e vlerësimit të konformitetit bien në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, zbatohen dispozitat e këtij ligji.

Neni 27

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

Neni 28

Ligji nr.9097, datë 3.7.2003 “Për vlerësimin e konformitetit” dhe çdo akt nënligjor i dalë në zbatim të tij shfuqizohen.

Neni 29

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5422, datë 23.7.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

ANEKS

**Lista e rregullave teknike që miratohen nga
Këshilli i Ministrave (referuar nenit 8):**

Rregulla Teknike	Ministria përgjegjëse për përgatitjen e rregullave teknike dhe për autorizimin e organeve të autorizuara
a) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Makinerive”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
b) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Ashensorëve”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
c) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve nën Presion”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
ç) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Enëve të Thjeshta nën Presion”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
d) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve nën Presion”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
dh) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve me Presion të transportueshme”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
e) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Boilerëve për ujë të nxehtë që përdoren me gaz”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
ë) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve të gazit”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
f) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve të tensionit të ulët”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
g) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Përputhshmërisë Elektromagnetike”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
gj) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Paisjeve dhe sistemeve mbrojtëse në mjedise me rrezik shpërthimi (miniera etj.)	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës

h) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Instalimeve kablllore për transportimin e njerëzve”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
i) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve shtëpiake frigoriferike dhe ngrirëse në lidhje me kërkesat e efikasitetit të energjisë”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
j) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Produkteve në lidhje me etiketën e konsumit të energjisë”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
k) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve në mjedise të hapura në lidhje me emetimin e zhurmave në mjedis”	Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave
l) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Instrumenteve Matëse”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
ll) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Instrumenteve të peshimit joautomatike”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
m) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Lodrave”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
n) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve të radiove dhe terminaleve të telekomunikacionit”	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
nj) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve të Mbrojtjes Personale”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
o) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve çlodhëse”	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
p) “Për Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Mjekësore”	Ministria e Shëndetësisë
q) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Mjekësore aktive të transplantueshme”	Ministria e Shëndetësisë
r) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve Mjekësore diagnostikuese <i>in vitro</i> ”	Ministria e Shëndetësisë
rr) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Produkteve të ndërtimit”	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
s) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Produkteve në lidhje me paketimin dhe mbeturinat e paketimit”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
sh) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të lëndëve plasëse për përdorim civil”	Ministria e Mbrojtjes
t) “Për Kërkesat Thelbësore dhe Vlerësimin e Konformitetit të Pajisjeve detare”	Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
th) “Për kërkesat e efikasitetit të energjisë për pajisjet e vogla elektronike dhe ndriçimin fluoreshent”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës
u) “Për mbetjet e pajisjeve elektrike dhe elektronike”	Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës